



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
REKTORATI

Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës vizitohet nga Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë

Ditën e martë datë 10 Korrik 2018 realizoi një vizitë në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Ambasadori i Turqisë në Tiranë Z. Murat Ahmet Yoruk i shoqëruar nga zv/Ambasadori, Sekretare e Parë e Ambasadës, Atasheu Tregëtar dhe Atasheu i Sigurisë.

Delegacioni u prit në Universitet nga Rektori Prof. Dr. Bektash Mema, zv/Rektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor Prof. Asoc. Valbona Duri, zv Rektori për procesin mësimor Prof. Asoc. Jani Dine, Dekani i Fakultetit Ekonomik Prof. Asoc. Ermonela Ruspi, Dekani Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore Prof. Dr. Gëzim Sala, Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës Prof. Asoc. Selfo Oruçi dhe Administratori Universitetit z.Gentian Llogo.

Në fjalën e mirëseardhjes Rektori Mema vlerësoi vizitën e Ambasadorit Turk dhe grupit që e shoqëronte dhe bëri një prezantim të Universitetit. Në vazhdim Rektori kerkoi që të nxitet partneriteti me universitetet publike dhe private turke ; krijimin e mundësive të diplomave dhe programeve të përbashkëta ; ndërtimin e partneriteteve midis programeve të UGJ-së dhe Universiteteve publike e private në Turqi si dhe aplikimin për fondet evropiane të arsimit të lartë, siç është projekti Erasmus +, Horizon 2020 dhe projekte të tjera.Shkëmbimet e stafit akademik dhe studenteve në fusha të ndryshme akademike dhe kërkimore shkencore ishin një tjetër aspekt i propozuar për bashkepunim.

Bashkëpunime ndëruniversitare por edhe me institucione te tjera turke për projekte të ndryshme në fusha si, turizëm , trashëgimi kulturore, edukim etj

Ambasadori turk falenderoi për mikëpritjen dhe vlerësoi seriozitetin në organizimin e takimit, duke përmendur faktin se vinte nga i njëjti qytet ku kishte lindur edhe albanologu i madh që i ka dhënë emrin këtij universiteti Eqrem Çabej, nga qyteti Eskisehir dhe se bashkëpunimi duhet të niste me dy universitete aty, Universitetin e “Anadollu” dhe Universitetin “Osman Gazi”.

Gjithashtu Ambasadori kërkoi mundësinë e vendosjes së gjuhës turke si lëndë me zgjedhje që tju jepet mundësi studentëve të universitetit të vazhdojnë studimet në nivelin master e doktorature në universitetet turke. Për këtë qëllim ai kërkoi vendosjen në universitet të një zyre të Institutit të kulturës turke “Yunus Emre” dhe sjelljen e një Lektorit turk për mësimin e gjuhës turke nga ana e studentëve.

Fushat e bashkëpunimit ngelen të hapura dhe gjithmon do të kenë mbështetjen e tij dhe të qeverisë turke.

Universiteti i Gjirokastrës ka bashkëpunime me disa universitete turke:

1. Universiteti i Trakisë Edirne
2. Universiteti i Kahraman Mehmet bej në Kahraman Anadoll
3. Universiteti Selcukut në Konja

Me universitetet e mësipërme kemi implementuar marrëveshje në programin Mevlana (program i Shtetit Turk) dhe jemi duke zbatuar shkëmbime mes stafit akademik dhe stafit studentor

Universiteti Trakisë në Edirne ka shkëmbyer 1 student në studime të Gjuhës Shqipe

Universiteti Karahman Mehmet Bej

1 student nga Cikli Ulet (ne Tetor 2018)

Universiteti yne do të dërgoj 3 studentë në Edirne për Gjuhe Angleze Shqipe ose Greke

Ndërkohë ka 60 kuota shkëmbimi për studentet me universitetin Kahraman Mehmet Bej.

Me të tre univeristetet kemi aplikuar për bashkëpunime dhe në programin Erasmus në shkëmbim stafi akademik apo studentë dhe projekte ngritje kapacitetesh në fusha të ndryshme

Në muajin Prill 2018 ka patur një bashkëpunim me Universitetin Hacetepe Stamboll për një konferencë Nderkombetare Studentore ku universiteti ynë u prezantua me 5 studente nga departametet e Financës dhe Turizmit.



